



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Për Shtyp

Rasti: Përftimi i kontrollit të Adria TopCo B.V. nga Summer BidCo B.V.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës me shkresën Nr. 581 Prot., protokoll i AK, datë 15.10.2018 “Përqendrimi nëpërmjet transaksionit të blerjes së United Group nga ana e Summer BidCo B.V. - njoftim në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës”, përfaqësuesi ligjor Kalo & Associates, ka njoftuar në lidhje me transaksionin e blerjes së Adria TopCo B.V. nga Summer BidCo B.V.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Referuar “Marrëveshje për blerje aksionesh” palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Summer BidCo B.V., e cila është një ndërmarrje e krijuar rishtazi, e kontrolluar nëpërmjet një zinxhiri ndërmarrjesh të tjera për qëllime të veçanta nga Summer Invest S.a.r.l., Kjo e fundit zotërohet nga BC European Capital X. Të gjitha këto shoqëri bëjnë pjesë në Grupin BC Partners. Objekti i shoqërisë Summer BidCo B.V. është të marrë pjesë dhe të financojë shoqëritë dhe bizneset; të bashkëpunojë, të operojë dhe menaxhojë punët dhe t’u ofrojë këshillim dhe shërbime të tjera shoqërive dhe bizneseve të tjera; të japë dhe marrë hua; t’u japë kolateral për borxhet dhe obligacionet e tjera të shoqërisë shoqërive dhe bizneseve të tjera etj.

Pala shitëse: Adria LuxCo S.a r.l. është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Luksemburgut. Objekti i veprimtarisë së saj është të veprojë si një shoqëri *holding* dhe të koordinojë aktivitetin e çdo personi juridik me të cilin shoqëria është e interesuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, dhe për të marrë të gjitha ose pjesë të kuotave, grupe të obligacioneve, bonove dhe titujve të tjerë të lëshuar ose të garantuar nga çdo person dhe çdo aktiv tjetër i çdo lloji duke i mbajtur ato si investime, t’i shesë, shkëmbejë, të kryejë çdo tregti ose biznes ose të blejë të gjithë ose pjesë të bizneseve; të blejë, të marrë me qira, të shkëmbejë, të japë me qira çdo pasuri të vërtetë ose personale dhe çdo të drejtë ose privilegj mbi të dhe në lidhje me të etj.

Adria TopCo B.V. (target) është një shoqëri holding, përgjegjëse për menaxhimin e aktiviteteve të shoqërive të ndryshme operative në Evropën Qendrore dhe Lindore në fushën e telekomunikacionit .

Adria TopCo zotërohet në mënyrë të tërthortë nga Grupi KKR.

KKR është një firmë investimesh globale e cila zotëron gjithashtu United Group ku kjo e fundit realizon xhiro në Shqipëri nëpërmjet Direct Media SHPK.

Në datën 27 shtator 2018 është nënshkruar “Marrëveshja për blerje aksionesh” të shoqërisë Adria TopCo B.V. nga Summer BidCo B.V.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.